



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.09.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit
2. Raportim i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për Fondin e Kompensimit; çfarë është realizuar deri tani, paratë që janë paguar sipas rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017”, datë 21.06.2018.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Reme Lala, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Ervin Bushati, Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Ervin Koçi – Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Lyela Rama – Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

Violanda Theodhori – Drejtor i Departamentit Juridik

Fatbardha Hebovija – Drejtor i Drejtorisë së Zbatueshmërisë

Edvin Peci – Specialist i Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Medien

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot, sipas kalendarit të miratuar, kemi vetëm një çështje në rendin e ditës: raportimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për Fondin e Kompensimit, për veprimtarinë e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. E gjitha kjo buron nga rezoluta e Kuvendit e miratuar për aktivitetin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2017, detyrat e lëna për vitin 2018 dhe detyrimet e vendosura për të raportuar çdo tre muaj në raport me problematikën e fondit të kompensimit dhe pagesat e kryera në raport me detyrimet që janë vendosur edhe nga ky komision.

Pikërisht për të raportuar në Komisionin e Ekonomisë ndodhet drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, zoti Ervin Koçi.

Në fillim do të prezantojë zoti Koçi raportin e tij, pastaj do të vijojmë me pyetje, përgjigje dhe diskutime.

Fjalën e keni ju.

Ervin Koçi – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë të komisionit,

Autoriteti në raportin vjetor të paraqitur në Kuvend në muajin maj ju informoi në lidhje me problematikën e trashëguar për fondin e kompensimit. Kjo problematikë 16-vjeçare e akumuluar nga viti në vit është pjesë e rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për aktivitetin e Autoritetit për vitin 2018.

Ju falënderoj që i dhatë mundësi Autoritetit që, me anë të kësaj seancë dëgjimore, t'ju informojë ju si komision për fondin e kompensimit, si dhe opinionin publik që historia e mospagesave dhe problematikës së fondit të kompensimit tashme po mbyllet si kapitull dhe Autoriteti çdo ditë është në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorit.

Gjatë vitit të kaluar dhe në vazhdim puna e autoritetit është përqendruar tek evidentimi dhe dhënia zgjidhje e problemeve të akumulura ndër vite, duke filluar nga viti 2002, në Byronë Shqiptare të Sigurimit. Këto problematika janë ngritur me shqetësim shumë të madh edhe nga komisioni juaj. Gjatë kësaj kohe kemi marrë një sërë masash për t'i dhënë fund një herë e mirë kësaj problematike që ka sjellë edhe mosbesim në tregun e sigurimeve.

E kemi rritur shumë herë fondin e kompensimit, krahasuar më vitet e kaluara gjatë të cilave ky fond në vit ka pësuar rritje dhe vonesa në pagesa në dëm të qytetarëve. Kemi ndryshuar edhe aktet rregullative për shpërndarjen e praktikave të dëmeve të fondit të kompensimit të shoqëritë e sigurimit nga Autoriteti, por edhe me një mbikëqyrje më efektive të Byrosë, duke monitoruar hap pas hapi shpërndarjen e të gjitha dosjeve dhe pagesën e dëmeve për detyrimet e prapambetura.

Siç ju informuam edhe gjatë raportimit vjetor, Autoriteti, referuar situatës së fondit të kompensimit, në muajin dhjetor 2017 ka marrë vendimin për fondin e kompensimit të vitit 2018, një vendim krejt ndryshe nga çdo vendim i mëparshëm që ka marrë Autoriteti për fondin e kompensimit, i konceptuar si më poshtë: kryerjen e pagesave të detyrimeve të prapambetura, për të cilat ka përfunduar procesi i trajtimit; për çdo vendim gjyqësor të formës së prerë që merret gjatë vitit 2018 të autorizojë shoqëritë për pagesë, si dhe krijimin e rezervës së fondit të kompensimit për dëmet që janë në proces gjyqësor apo trajtimi, me objektivin për ta zgjidhur një herë e mirë këtë problematikë.

Fondi i kompensimit për detyrimet e prapambetura për vitin 2018 është rreth 1,67 miliardë lekë, ku 923 milionë lekë janë detyrime të prapambetura, të cilat janë për t'u ekzekutuar dhe 745 milionë lekë janë për ngjarjet e sigurimit, të cilat janë në proces trajtimi apo që nuk kanë pasur vendim të formës së prerë.

Nga asambleja e Byrosë shuma për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ishte propozuar 500 milionë lekë, ndërsa vendimi i Autoritetit ishte 3, 3 herë më shumë se propozimi i Byrosë, që është shumë më shumë, po të krahasosh me tre vjetët e marrë së bashku, pra vitet 2014, 2015, 2016.

Pagesat e kryera deri tani nga të gjitha shoqëritë për fondin e kompensimit janë 541 milionë lekë ose 59% e vlerës së përcaktuar me vendimin e bordit për detyrimet e prapambetura, ku disa shoqëri kanë ritme më të larta pagese se disa të tjera.

Aktualisht, shoqëritë e sigurimit, veç pagesave prej 541 milionë lekësh, kanë lidhur marrëveshje për të paguar me këstet e nënshkruara me palët përfituese ose më përfaqësuesit ligjorë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale prej rreth 303 milionë lekësh. Me ndryshimet e rregullores nr. 36 në muajin korrik 2018, Autoriteti për fondin e kompensimit ka shpërndarë praktika në vlerën 95 milionë lekë, kur Byroja dhe shoqëritë kanë pasur probleme ndarjeje për shkak të proceseve gjyqësore për ndarjen e fondit të kompensimit dhe vendimeve

gjqësore të formës së prerë që ka pasur gjatë viteve 2015-2016 dhe 2017. Byroja ka vijuar me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës së shoqërive të sigurimit për pagesën e vlerës prej 95 milionë lekësh.

Një vëmendje të veçantë Autoriteti i ka kushtuar edhe ecurisë së proceseve në gjykata, ku në zbatim, në mënyrë që të mos krijohet më akumulimi i fondit të kompensimit dhe, në zbatim të vendimit të bordit të muajit dhjetor të vitit të kaluar, ndër të tjera, është përcaktuar se Byroja Shqiptare e Sigurimit do të shpërndajë te shoqëritë e sigurimit dhe do të autorizojë për pagesë praktikën që janë objekt i fondit të kompensimit, të cilat përfundojnë procesin e trajtimit apo për të cilat shpallet një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Gjatë vitit 2018 janë marrë 59 vendime të formës së prerë, që ishin në gjykim me vlerë totale 227 milionë lekë, ku të gjitha janë shpërndarë për pagesë në shoqëritë e sigurimit, sipas vendimit nr. 14, datë 15.08.2018 “Për shpërndarjen e praktikave fond kompensimi me datë aksidenti deri më 31.12.2013.

Aktualisht, mbeten në proces gjyqësor të papërfunduara në shkallë të parë dhe në apel 51 dosje me vlerë rreth 194 milionë lekë. Ndërsa për ngjarjet pas 1 janarit të vitit 2014 e në vazhdim, sipas inspektimit të kryer pranë shoqërive të sigurimit dhe BSHS-së, janë në proces trajtimi rreth 119 praktika, 79 gjyqësore në Shkallë të Parë, 34 në Gjykatën e Apelit dhe 6 në Gjykatën e Lartë, për të cilat është marrë vendimi i pezullimit për mosekzekutim. Kjo kap vlerën 211 milionë lekë. Duke u shpërndarë të gjitha dosjet e akumuluar në Byro për shumë vite, për të mos u ndodhur përsëri në përsëritjen e këtij fenomeni, tashmë për çdo vendim gjyqësor të formës së prerë apo ngjarje sigurimi, që miratohet nga Byroja, autorizimi për pagesë nga Byroja do të shpërndahet brenda 7 ditëve. Nëse Byroja nuk e kryen këtë shpërndarje, me ndryshimet në rregullore që miratohet në korrik, shpërndarjen e dosjeve e kryen Autoriteti.

Autoriteti përveç rëndësisë së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, i ka kushtuar rëndësi të veçantë dhe fondit të kompensimit në tërësi, me qëllim që fenomeni i akumulimit të mos vazhdojë përsëri, për këtë qëllim janë kryer dhe po kryhen inspektime të vazhdueshmen me baza 3-mujore.

Nga inspektimi i kryer në maj të vitit 2018, Autoriteti, referuar pagesave dhe detyrimeve për periudhën deri më 30 prill 2018, arriti në përfundimin se dëmet e fondit të kompensimit për ngjarjet pas 1 janarit të vitit 2014 e në vazhdim (të miratuara pa paguar dhe përmbartimore) ishin rritur në vlerën 227 milionë lekë për shkak të ndryshimit të statusit gjyqësor, pasi ishin marrë

vendime të formës së prerë gjatë kësaj periudhe, si dhe vendime administrative për dosjet që kishin qenë në proces trajtimi.

Bordi i Autoritetit, pas propozimit të Byrosë në fund të muajit korrik, ka miratuar shtesën e fondit të kompensimit për vitin 2018 për këto dosje, në mënyrë që të fillojë menjëherë shlyerja e tyre. Byroja Shqiptare e Sigurimit ka shpërndarë të gjitha dosjet dhe ka dërguar autorizimin për ndjekjen e procedurës së pagesës pranë shoqërive të sigurimit.

Aktualisht ne po vijojmë me inspektimin pranë shoqërive të sigurimit për ecurinë e pagesave të këtij fondi shtesë.

Një tjetër pikë e rezolutës ishte dhe zgjedhja e drejtorit ekzekutiv të Byrosë, ku asambleja e përgjithshme e anëtarëve, pas refuzimit të kandidaturës së propozuar më parë nga Autoriteti, ka propozuar një kandidaturë tjetër për drejtor ekzekutiv, i cili është miratuar nga bordi i Autoritetit në mesin e muajit korrik. Njëkohësisht, ne ju informojmë se shoqëria audituese ndërkombëtare, e përzgjedhur nga asambleja për kryerjen e auditimit të veprimtarisë së Byrosë, ka filluar procesin e auditimit pranë Byrosë. Gjithashtu, për të pasur një miradministrim të dosjeve të fondit të kompensimit, por edhe të funksionimit të Byrosë, Autoriteti e ka konsideruar shumë të nevojshme nevojën për ndërhyrje në rregulloren për krijimin, llogaritjen, financimin, administrimin e fondit të kompensimit dhe kryerjen e pagesave të dëmeve. Konkretisht, në qoftë se Byroja Shqiptare e Sigurimit nuk bën shpërndarjen e praktikave të dëmeve të fondit të kompensimit të shoqëritë e sigurimit anëtare të saj, sipas vlerave respektive të detyrimeve të tyre, shpërndarja për pagesë të shoqëritë e sigurimit do të bëhet nga vetë Autoriteti. Byroja Shqiptare e Sigurimit brenda 7 ditëve nga data e marrjes në dijeni nga Autoriteti të shpërndarjes së praktikës do të vijojë me dërgimin e autorizimit dhe kopjen e praktikës të shoqëria e sigurimit e caktuar nga Autoriteti. Shoqëria e ndjek procedurën e rimbursimit sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje. Pra, edhe pse ndarjet e dosjeve dhe autorizimet e lëshuara për këtë dosje janë një arritje, është rritur edhe vetë sensibilizimi i një pjese të konsiderueshme të shoqërive. Për të ardhmen ne do të vazhdojmë të fokusohemi te ndjekja sistematike e pagesave dhe zbatimi i afateve kur marrëveshjet janë me këste, do të vazhdojë kryerja e inspektimeve çdo 3-mujor për të parë ecurinë e këtij procesi, njëkohësisht do të vazhdojmë të ndjekim procesin e përditësimit të Byrosë dhe në funksion të rezultateve të auditimit të merren masat e duhura për një funksionim sa më normal të Byrosë dhe të vazhdojmë të rrisim rolin mbikëqyrës nga Zyra e Mbikëqyrjes së Byrosë dhe departamentit përkatës për të siguruar një informacion sa më të shpejtë dhe të saktë

për të marrë vendimet e duhura në kohë. Njëkohësisht do të vazhdojmë të përshkallëzojmë masën mbikëqyrëse për shoqëritë që nuk zbatojnë nivelin e pagesave dhe afatin e shlyerjeve sipas marrëveshjes.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, ju garantojmë se ne do të përmbylлим me shumë përgjegjshmëri këtë proces mjaft të rëndësishëm dhe shumë sensibilizues për opinionin publik, por edhe për Komisionin e Ekonomisë.

Erion Braçe – A ka pyetje? Materiali ka qenë i shpërndarë për të gjithë kolegët, nëse ka pyetje lidhur me raportimin, mundeni.

Urdhëroni, zoti Xhelilaj!

Roland Xhelilaj – Me materialin jemi njohur. Kam dy pyetje, të cilat realisht nuk ndalojnë drejtpërdrejt tek të dhënat. Dua një informacion se çfarë lloj raporti ka Autoriteti me Byronë Shqiptare të Sigurimeve?

Së dyti, te rezultatet e arritura shikojmë një përmirësim të madh dhe të vlefshëm, por kam një merak, ky lloj rezultati vjen nga një lloj presioni i Komisionit të Ekonomisë dhe nga personat përkatës që drejtojnë sot Autoritetin, apo ka bazë reale detyruese në vazhdimësi?

Ervin Koçi – Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së parë, Autoriteti ka rolin mbikëqyrës në Byronë Shqiptare të Sigurimit, por mënyra se si është organizuar funksionimi i Byrosë është Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Byrosë, e cila merr të gjitha vendimet dhe bën propozimet përkatëse në Autoritet. Ky ka qenë një problem, sepse, duke qenë se anëtarët e Asamblesë janë drejtorë të përgjithshëm të shoqërive të sigurimit, shpeshherë krijohet konflikt interesi, për shkak se të interesuarit mbulojnë interesat e shoqërive të tyre.

Gjithsesi, ne e kemi rritur shumë rolin mbikëqyrës, për shkak sepse edhe me strukturën e re të krijuar më 1 tetor të vitit të kaluar, ne krijuam Zyrën e Mbikëqyrjes së Byrosë, e cila nuk ekzistonte, duke krijuar edhe një mungesë informacioni ose inspektimesh të nevojshme për të parë ecurinë e këtij procesi ose për të marrë masat dhe mendimet në kohën e duhur.

Gjithsesi, këtë proces ne e kemi zgjidhur edhe nëpërmjet komunikimit zyrtar, shkresor, pa diskutim edhe penalizues, por e rëndësishme është që në ligjin e ri, që besoj se do të miratohet së shpejti, kjo çështje të zgjidhet. Asambleja e Byrosë do të përbëhet nga profesionistë dhe do të jetë Autoriteti që do të ketë rolin kryesor, në mënyrë që të mos vazhdojë kjo histori e akumuluar ndër vite, edhe me kosto të mëdha për qytetarët.

Për sa i përket pyetjes së dytë, unë mendoj se ato që thatë ju janë faktorë të rëndësishëm, pa diskutim edhe sensibilizimi publik nga Komisioni i Ekonomisë ka dhënë efektin e duhur, por edhe ne si Autoritet kemi marrë një plan masash, në mënyrë që ne të ndryshojmë tërësisht funksionimin e këtij procesi, por njëkohësisht do të shikojmë të gjitha dosjet.

Faktikisht, ky ka qenë një problem, sepse rritja e pagesave ka pasur një reagim nga shoqëritë, të cilët nuk ishin mësuar me këtë lloj presioni apo me këto lloj vendimesh, të cilët ndryshojnë radikalisht administrimin e fondit të kompensimit dhe të Byrosë. Gjithsesi, unë mendoj se pjesa më e madhe janë sensibilizuar dhe ecin në rrugë të mbarë.

Unë e falënderoj edhe Komisionin e Ekonomisë, në mënyrë që presionet pozitive të ndikojnë për të çuar mesazhe pozitive te tregu. Kjo akumulohet nga viti në vit, nuk kishte asnjë ndërhyrje.

Në pamje të parë ne kemi bërë një informacion të thjeshtë, por po të hysh te Byroja, nga viti 2002 nuk ka pasur një mbajtje të të dhënave në mënyrë konstante. Ne jemi duke investiguar edhe dosjet, të cilat mendojmë se janë objekt mashtrimi. Po ta shikoni, është vetëm një dosje e pashpërndarë, të cilën po e investigojmë, sepse ka burime që ka pasur një objekt mashtrimi.

Unë dua të jap një mesazh edhe për shoqëritë, edhe për publikun, që, në qoftë se ata kanë shqetësime ose probleme, mund të ankohen menjëherë tek Autoriteti, sepse në deklarin publik që kemi bërë, çdo ankesë të tyre, që është për fond kompensimi, ne e trajtojmë brenda 24 orëve, në mënyrë që ta fusim në rrugën e zgjidhjes.

Faleminderit!

Xhevit Bushaj – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, drejtues i AMF-së!

Unë kam dy pyetje.

Së pari, nga shpjegimet që ju bëtë, dëgjova se ka probleme me krijimin e fondit të kompensimit, me shpërndarjen e dosjeve dhe problematika të tjera. Shoh se nuk ka sanksione dhe norma të përcaktuara për krijimin e këtij fondi apo për shpërndarjen e dosjeve, afate normative.

Së dyti, a ka vakum ligjor në marrëdhëniet midis këtyre institucioneve, që mbulohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kjo nisur edhe nga eksperiencia që keni marrë gjatë kohës që drejtoni dhe menaxhoni këtë institucion?

Faleminderit!

Ervin Koçi – Pa diskutim që ka një vakum ligjor, për shkak se në ligj më shumë kompetenca dhe pushtet i është dhënë asamblesë, e cila bën propozime, por nuk besoj se ne duhet të justifikohemi me këtë vakum ligjor, sepse ne duhet të sensibilizojmë shoqëritë që kjo është një përgjegjësi shumë e madhe, sepse tregu i sigurimeve, me problematikat që ka, duhet të dalë nga mosbesimi që ka publiku.

Normalisht, po të shikojmë vendimet që ka marrë Byroja ndër vite, ato janë sanksionuar nga Autoriteti me të njëjtin propozim që ka bërë Byroja. Vitin e kaluar ne e shtuam fondin me 250 milionë lekë dhe këtë vit 3,3 herë më shumë sesa atë që propozoi Byroja. Shpeshherë edhe shoqëritë ankohen dhe kjo ndodh për tejkallim kompetencash të Autoritetit. Unë mendoj se ky nuk është tejkallim kompetencash, por zbatim dhe korrektësi në funksion të mbrojtjes së konsumatorëve.

Gjithsesi, e thashë edhe pak më parë që i gjithë ky vakum ligjor, i cili krijohet dhe i jep pushtet drejtorit të përgjithshëm të Byroja, tashmë, me ligjin e ri, e ndryshon këtë. Ne harxhojmë shumë energji, shumë shkresa për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi.

Sa për çështjen e parë, fondi i kompensimit, sipas ligjit, duhet të shlyhet brenda vitit. Ka që nga viti 2002 që ky fond nuk shlyhej dhe akumulohet. Po të shikoni fondin e kompensimit në vitet 2002-2013 shkon rreth 3 miliardë lekë, që nuk ishin paguar. Kjo tregon se ky afat nuk është respektuar. Në vendimin që morëm në muajin në dhjetor vendosëm që detyrimet e prapambetura të paguheshin dhe në qoftë se del vendim i gjykatës së formës së prerë, të negociohet me qytetarët për të hyrë menjëherë në pagesë.

Së treti, çdo dosje, e cila në gjykatë është në proces trajtimi, t'i ketë rezervë në bilancet e saj.

Erion Braçe – A ka pyetje?

Unë kam disa pyetje. Me thënë të drejtën, e kam lexuar tri herë raportin, (madje të gjatë) kur thelbi i raportimit tuaj duhet të ishte shumë më i thjeshtë. Ne kemi kërkuar të dimë se si ecën puna me shlyerjen e dëmeve të prapambetura, të akumuluar nga Byroja Shqiptare e Sigurimeve. Tani, nga të gjitha numrat që janë këtu më lind e drejta që të pyes edhe një herë: sa është detyrimi për t'u shlyer për ngjarje sigurimi deri në fund të vitit 2013?

Ervin Koçi - Përveçse këto përcaktohen në vendimin e bordit, 817 milionë lekë...

Erion Braçe - Nuk më duhet fare vendimi i bordit. Dua të di: sa është detyrimi për ngjarje sigurimi që kanë ndodhur deri në fund të vitit 2013? Pra, dua një shifër.

Ervin Koçi – Zoti kryetar, dua ta sqaroj pak këtë, meqenëse janë edhe në proces me gjykatat...

Erion Braçe – Dua të më sqaroni këtë që e keni lëshuar këtu. Pra, dua tri shifra të qarta dhe dua të mbani përgjegjësi për shifrat që jepni këtu.

Ervin Koçi - 817 milionë lekë janë përcaktuar në fillim të vitit që janë detyrim për dosjet që ishin miratuar në proces pagese...

Erion Braçe – Kjo gjë nuk më intereson fare. Edhe një herë, dua të di: sa është fondi për ngjarje sigurimi i akumuluar deri në fund të vitit 2013? Pra, sa është vlera që këto kompani duhet t'u paguajnë qytetarëve që janë të siguruar? Këtë dua të di.

Ervin Koçi – Duke zbritur edhe pagesat që janë bërë deri tani...

Erion Braçe – Kjo nuk më intereson fare. Dua të di: sa është potencialisht?

Ervin Koçi – Zoti kryetar, të lutem, më lër të mbaroj, sepse do ta sqaroj në fund!

Erion Braçe – Nuk dua që të vazhdosh, sepse jam i bindur që do të më thuash përsëri të njëjtën gjë.

Ervin Koçi - Jo, nuk do të them atë zoti kryetar.

Erion Braçe - Kjo gjë është e paqartë. Tani, edhe një herë, dua të di: sa është vlera e të gjithë dëmeve me ngjarje sigurimi deri në fund të vitit 2013?

Ervin Koçi – Aktualisht, duke futur edhe vendimin e fundit që mori asambleja...

Erion Braçe – Nuk më intereson vendimi i asamblesë, dua të di....

Ore, zotëri, kanë ndodhur ngjarje sigurimi deri në fund të vitit 2013, sa është vlera e dëmeve të shkaktuara?

Ervin Koçi – Zoti kryetar, nuk e kuptova mirë pyetjen.

Erion Braçe - Kanë ndodhur ngjarje sigurimi deri në fund të vitit 2013, apo jo?

Ervin Koçi – Po.

Erion Braçe - Është akumuluar, nuk janë paguar e të tjera me radhë, dua të di: sa është kjo vlerë deri në fund të vitit 2013?

Ervin Koçi – E doni deri në datën e sotme?!

Erion Braçe – Ore, zotëri, nuk po të pyes se sa ke paguar, më pas do të pyes se sa ke paguar, dua të di: sa është dëmi që nuk është paguar deri tani?

Ervin Koçi – 718 milionë e 777, zoti kryetar, duke futur dhe vendimet gjykatës...

Erion Braçe – Sa janë paguar nga 718 milionë e 777?

Ervin Koçi - Në vitet 2012-2013 janë paguar...

Erion Braçe – Sa janë paguar në total?

Ervin Koçi - Për vitet 2012-2013 janë paguar 407 milionë.

Erion Braçe – Pse nuk është paguar diferenca?

Ervin Koçi - 303 janë lidhur në marrëveshje, pra kanë filluar të paguhen me këste.

Erion Braçe - 303 janë marrëveshje me kësht pagese?!

Ervin Koçi - 95 milionë i ka shpërndarë Autoriteti në muajin gusht, pas vendimit që morëm në fund të muajit korrik...

Erion Braçe - Pra, po më thoni se për ngjarje sigurimi deri në fund të vitit 2013 është shlyer i gjithë fondi?

Ervin Koçi - Jo, nuk është shlyer, janë 718 milionë lekë në proces pagese. Nga 718, 302 janë paguar me këste, 95 i ka shpërndarë Autoriteti në muajin gusht, që kanë hyrë në procesin e pagesës, dhe me vendimet e gjykatës së formës së prerë që janë marr gjatë këtij viti, janë dhënë 228 milionë lekë dhe në muajin gusht janë shpërndarë të gjitha pagesat nga shoqëritë e sigurimit.

Erion Braçe - Po 303 dhe 95 dhe 200 e ca, sa bëjnë? Sepse dalin më shumë se 718.

Ervin Koçi - Nuk dalin zoti kryetar.

Erion Braçe – Më thatë se 718 milionë është i gjithë fondi; më thatë se 407 milionë janë paguar; më thatë se 303 janë me marrëveshje dhe tani po më thoni se 95 i keni shpërndarë ju në gusht.

Ervin Koçi - Po.

Erion Braçe – Po më thoni se edhe 200 e ca të tjera janë me vendim gjykatë të formës së prerë. Po sa bëjnë 400+300+ 95+ 200?! 718 bëjnë?!

Fatbardha Hebovija – Faleminderit!

Dua të bëj një sqarim: në dhjetor të vitit 2017, kur u mor vendimi i bordit, shuma totale e detyrimeve për fondin e kompensimit për ngjarjet deri më 31 dhjetor është rreth 1,2 miliardë lekë.

Erion Braçe – Sa janë paguar nga këto?

Fatbardha Hebovija – Nga kjo vlerë janë paguar rreth 409 milionë lekë për ngjarjet e vjetra.

Erion Braçe – Ngjarje të vjetra?!

Fatbardha Hebovija – Bëhet fjalë për ngjarje deri më 31.12.2013, pra po flasim për këto që janë të prapambetura; janë shpërndarë rreth 247 milionë lekë dosje...

Erion Braçe – Të kësaj periudhe, pra deri në vitin 2013?

Fatbardha Hebovija – Po. 302 milionë lekë janë marrëveshje me këste. Dua të theksoj, vlera e detyrimeve të prapambetura për këto ngjarje çdo ditë ndryshon për shkak të ndryshimit të statusit, interesave dhe tarifave përmbarimore.

Erion Braçe – Përsëri nuk më dalin numrat, ngeli një 200-milionësh. **Fatbardha Hebovija** – Pjesën tjetër e kanë shoqëritë, të cilat nuk janë me marrëveshje, por do të paguhen në vijim, pra pjesa tjetër e praktikave që nuk korrespondon në shumën totale.

Erion Braçe – Duke mbajtur potencialisht këto 302 milionë, që qenkan me marrëveshje midis palëve për t'u paguar me këste, deri tani nuk është paguar as 40% e këtij fondi, apo jo?

Ervin Koçi - Zoti kryetar, këto dosje janë shpërndarë në muajin gusht dhe ne jemi në inspektim që kanë hyrë procesin e pagesës për pagesën me autorizim.

Erion Braçe – Drejtor keni marrë një angazhim para këtij komisioni se në datën 1 janar 2019, 1,2 miliardë duhet të jenë të ezauruara, pra duhet të jenë zero.

Ervin Koçi – Patjetër.

Erion Braçe - Kjo zeroja nuk bëhet zero me marifete. Kjo do të thotë se nuk bëhet zero as me dosje, që rishpërndahen në muajin nëntor, as me vullnetin e kompanive për të shlyer ndonjë pjesë të këtij detyrimi, apo angazhimit të kompanive me zë, me figurë apo me shkrim se do ta shlyejnë këtë gjë.

Raporti që kam para, të cilin e keni hartuar ju, bën fjalë për një detyrim të fondit të kompensimit për vitin 2018 në vlerën 923,3 milionë lekë, i cili është ezauruar deri tani në masën 59%. Vetëm dy kompani e kanë shlyer detyrimin në masën 80% nga të gjitha këto që janë këtu. Ndërkohë, ka kompani që janë me nivel shlyerje të detyrimit me 25%. Si mendoni ju, se shlyerja e detyrimit do të jetë në masën 100% në datën 1 janar? Unë këtë nuk arrij ta kuptoj, megjithatë unë nuk kam lidhje dhe nuk kërkoj përgjegjësi te kompanitë. Ky komision i Kuvendit ka lidhje vetëm me ju dhe me askënd tjetër.

Së dyti, ju thoni këtu se janë ndërmarrë apo janë konsumuar 59 vendime gjyqësore të formës së prerë. Nga këto 59 vendime, 42 janë të shkallës së parë, të tjerat janë të Gjykatës së Apelit e të tjera me radhë. Unë dua të di: sa nga këto vendime janë ekzekutuar, sepse këtu po flasim për vendime gjyqësore?

Ervin Koçi – Gjithsej janë 59 vendime të formës së prerë, me vlerë rreth 228 milionë lekë, të cilat janë shpërndarë në datën 15 gusht dhe asambljetë kanë filluar procesin e pagesave. Tani ne jemi në inspektim për të parë...

Erion Braçe – Unë dua të di: nga këto 59 vendime gjyqësore të formës së prerë sa janë ekzekutuar? Pra, ishin 228 milionë. Sa janë paguar nga këto 228 milionë?

Ervin Koçi – Kryetar, këto para janë shpërndarë në muajin gusht.

Erion Braçe – Pra, këto 59 vendime gjyqësore gjykatat i kanë dhënë në muajin korrik?

Ervin Koçi – Jo, i kanë marrë në proces.

Erion Braçe – Pra i kanë marrë në proces dhe ju i grumbulloni?

Ervin Koçi – Kryetar, ky ka qenë një problemi. Ne kemi arritur të ndajmë të gjitha dosjet, sepse ka qenë një problem shumë i madh. Tani që dosjet u ndanë, ne e kemi më të lehtë, sepse çdo vendim gjykate që del e fusim menjëherë në proces pagese. Të 59 dosjet që janë ndarë në muajin gusht nga Byroja ne u kemi dhënë autorizimin përkatës. Në qoftë se shoqëritë nuk i paguajnë qytetarët, ata mund të ankohen te ne ose nëpërmjet zyrave përmbare, në mënyrë që të marrin paratë. Pra, kjo gjë e thjeshton shumë problemin. Gjatë gjithë kësaj kohe ne kemi punuar dhe jemi angazhuar që dosjet të ndaheshin, pasi ato akumuloheshin në Byro dhe nuk ndaheshin nga shoqëritë. Ne morëm një vendim: nëse shoqëritë nuk do t'i ndanin, ato do t'i ndante autoriteti. Tani që ky proces ka hyrë në këtë fazë dhe janë shpërndarë të gjitha dosjet, ne kemi vendosur që të marrim pjesë në të gjitha seancat që zhvillohen në Gjykatën e Apelit, në mënyrë që nëse vendimi del menjëherë, brenda 74 ditëve ne ta fusim në proces ekzekutimi. Pra, në qoftë se shoqëritë nuk e ekzekutojnë vendimin ka dy mundësi: ose qytetari do të bëjë një ankesë tek Autoriteti, ose te zyrat përmbare.

Erion Braçe – A mund të më thoni të cilave datave janë këto vendime gjyqësore, sepse bëhet fjalë për 59 vendime? Në çfarë viti janë marrë këto vendime? A janë marrë gjatë vitit 2018?

Ervin Koçi – Po, janë vendime të marra në vitin 2018.

Erion Braçe – Pra, ju apo Byroja keni pritur muajin gusht për t'i shpërndarë dosjet e këtyre?

Ervin Koçi - Byroja këtë e ka bërë pas presionit të bërë nga Autoriteti për të shpërndarë dosjet...

Erion Braçe – Çfarë është ky institucion që funksionon vetëm me presion? A mos është bankë? Ky institucion ka detyrime për t’u paguar qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Ata nuk i kanë paguar dhe qytetarët kanë qenë të detyruar të shkojnë në gjykatë dhe kanë marrë një vendim të formës së prerë të gjykatës. Atëherë, pse nuk paguhen këto para?

Ervin Koçi – Kryetar, ky është edhe problemi që ne kemi për shkak se asambleja përbehet nga drejtori i Përgjithshëm. Ne i kemi bërë propozimet përkatëse edhe bordit për të marrë masa konkrete ndaj çdo personi përgjegjës. Çështja është se nëse ky ligj do të vazhdojë të jetë në fuqi, gjithmonë do të kemi këtë handikap, sepse ata këtë gjë e bëjnë për të krijuar zvarritje dhe probleme. Gjithsesi, unë mendoj se tashmë procesi ka hyrë në fazën përfundimtare dhe do të zgjidhet brenda këtij viti, sepse tashmë të gjitha dosjet janë shpërndarë dhe nuk ka më dosje të pashpërndara. Pra, të gjitha kanë shkuar për pagesë pranë shoqërive të sigurimit. Në qoftë se sot del një vendim gjykate, menjëherë, brenda 7 ditëve, do të futet në proces pagese. Ne i kemi dhënë zgjidhje kësaj problematike të madhe, sepse asambleja nuk i shpërndante dosjet.

Erion Braçe – Pra, ju mendoni se shpërndarja e dosjeve është çështje administrative?! Atëherë, kam një pyetje: si mendoni ju që kompania “EUROSIG”, e cila deri tani ka shlyer vetëm 25% të fondit të detyrimit, do t’i shlyejë deri në datën 1 janar të vitit 2019 edhe 75% të tjera?

Ervin Koçi – Disa gjëra duhen bërë edhe për shkak të stabilitetit të tregjeve, por gjithsesi kanë probleme në masën...

Erion Braçe – Jo, ju si mendoni se do të shlyhen këto?

Ervin Koçi – Ne kemi menduar që nëse shoqëria nuk i shlyen, do t’ia marrim ne.

Erion Braçe – Si do t’ia merrni juve?

Ervin Koçi – Nëpërmjet urdhrave ne do t’i marrim lekët dhe do t’ua japim qytetarëve.

Erion Braçe – Me çfarë baze ligjore do ta bëni këtë gjë?

Ervin Koçi – Lidhur me bazën ligjore kemi menduar që t’i fusim te fondi i garancisë për të marrë 370 milionë lekë për të pagur qytetarët.

Erion Braçe – Shoqëria “INSIG”, e cila deri tani ka shlyer vetëm 45% të fondit të parashikuar për vitin 2018, si do ta shlyejë pjesën tjetër?

Ervin Koçi – Shoqëria “INSIG” ka shlyer 45% dhe në marrëveshje ka 57 dhe nëse nuk i shlyen, do të veprohet e njëjta mënyrë dhe procedurë, siç e përmenda më parë.

Erion Braçe – Shoqëria “Atlantik”, e cila deri tani ka shlyer vetëm 58% të fondit, si do ta shlyejë pjesën tjetër?

Ervin Koçi – Besoj se kompanitë e tjera do ta shlyejnë detyrimin në 100%, sepse nuk kanë probleme me treguesit financiarë.

Erion Braçe – Pra, do t’i shlyejnë 100%?!

Tani që ta kuptoni ju dhe gjithë të tjerët: vlerat që duhet të paguajnë këto kompani nuk arrijnë në 500 mijë euro, ku shpenzimet lart e poshtë të këtyre kompanive, qoftë edhe vetëm për reklama janë të barabarta, madje edhe disa herë më të mëdha se këto detyrime. Kjo do të thotë se këto kompani i kanë kapacitetet për të paguar, por e kanë të fundit në radhë detyrimin për t’u paguar qytetarëve. Ky është problemi dhe ky problem lidhet me ju dhe me funksionimin tuaj. Ju thatë këtu se keni ndërtuar një zyrë për këtë punë. Cili është kapaciteti i kësaj zyre?

Ervin Koçi – Zyra ka vetëm një person.

Erion Braçe – Pse vetëm një person merret me këtë punë, që për ju është çështje themelore?!

Ervin Koçi – Kryetar, më parë nuk ka pasur asnjë, por sot është një person, i cili merret me zbatueshmërinë nëse janë të koordinuar.

Erion Braçe – Pra, ju po thoni se keni krijuar një zyrë vetëm me një njeri?!

Ervin Koçi – Zyra e drejtorit të departamentit është edhe Drejtoria e Mbikëqyrjes që...

Erion Braçe – Çfarë lidhje ka Drejtoria e Mbikëqyrjes me këtë punë?!

Ervin Koçi – Zbatueshmëria...

Erion Braçe – Më vjen keq, por Drejtoria e Mbikëqyrjes merret me tjetër gjë dhe nuk merret me mbikëqyrjen e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve. Kjo do të thotë se edhe kapacitet njerëzore që po merren me këtë punë janë të mangëta. Një njeri i vetëm që të merret me këtë proces, mua më duket shumë pak.

Ervin Koçi – Unë nuk besoj se është vetëm një person që merret me këtë proces.

Erion Braçe – A po thoni se zyra ka vetëm një njeri?!

Ervin Koçi – Po, sepse mendoj se e përballon si proces.

Erion Braçe – Ju jeni një autoritet i tërë dhe nuk po ia dilni dot, kurse ky njeri i vetëm do u marrka me këtë punë!

Ervin Koçi – Ky njeri ka si detyrë vetëm përpunimin e informacionit dhe përgatitjen e...

Erion Braçe – Në rregull, jam shumë i qartë, sepse detyrimi është juaji. Në datën 1 janar të vitit 2019 ne do të vijmë përsëri këtu dhe do t'i bëjmë llogaritë si ta mendoni ju me një njeri apo me dy e kështu me radhë. Tani, si do të shpërndahen këto dosje? Sepse ju thatë se shpërndarja e dosjeve ishte problemi më i madh.

Cili është mekanizmi me të cilin keni shpërndarë dosjet?

Ervin Koçi – Mekanizmi që ka shpërndarë Autoriteti apo shoqëritë?

Erion Braçe – Që kanë ndarë ata dhe ju.

Ervin Koçi – Byroja ndarjen e ka bërë duke u bazuar te përqindja e tregut që kanë pasur shoqëritë një vit më përpara dhe kanë bërë një ndarje të dosjeve parë se kush është shkaktari dhe joshkaktari, kush është i pidentifikuari dhe i identifikuari, në mënyrë që të ketë probabilitet të barabartë për sa u përket padive të regresit. Ndërsa nga ana jonë, për të qenë transparentë, kemi bërë ndarjet e dosjeve duke u bazuar në përqindjen e tregut kur ka ndodhur aksidenti. Pra, nëse ka ndodhur një aksident në vitin 2008 dhe një qytetari i takon të marrë 10 milionë lekë të rinj, vlerësimi është bërë me përqindjen e tregut të vitit 2008 dhe çdo shoqëri do të paguajë pjesën e vet sipas përqindjes së tregut që ka pasur në atë vit.

Erion Braçe – Kjo ishte për shoqëritë, tani dua të di në raport me qytetarët. Pra, mua më ka ndodhur aksidenti në vitin 2008 dhe normalisht unë jam në radhë për të marrë këtë gjë, tani dosja ime si shpërndahet në raport me këta të tjerët, kur më vjen radha të marr paratë?

Ervin Koçi – Tani nuk ka më radhë për të marrë paratë, tani me këtë proces që kemi...

Erion Braçe – Po a e dini se çfarë thonë? Besoj se e keni dëgjuar, apo jo? Që është kthyer në një proces tërësisht korruptiv dhe që duhet të lësh një vlerë nga masa e dëmit që t'i të paguhesh përpara të tjerëve, apo ti të marrësh paratë e tua që të takojnë sipas ligjit dhe sipas vendimit të gjykatës e të tjera me radhë në raport me shoqërinë. A e kuptoni se është kthyer në një instrument tërësisht korruptiv? Nëse ju si autoritet e vendosni në referencë datën kur ka ndodhur aksidenti, atje nuk ndodh kjo gjë, fare. Atje vetëm ai që ka mik, madje kush ka mik një deputet, ndonjë pushtetar dhe ndonjë të njohur mund të marrë paratë e veta dhe në fund fare duke lënë edhe pjesë. Ky është turpi.

Ervin Koçi – Zoti kryetar, ky është një shqetësim shumë i madh dhe ky ka qenë edhe shkak që nuk ndaheshin...

Erion Braçe – A mundeni të krijoni një instrument transparence në raport me këtë gjë?

Ervin Koçi – Zoti kryetar është shumë e drejtë kjo që thoni.

Erion Braçe – Drejtor, kur do të ndodhë? Kur? Po mbaron mandati im në krye të këtij komisioni dhe njerëzit ende vazhdojnë të paguajnë për të marrë lekët e tyre.

Ervin Koçi – Zoti kryetar, të lutem ta mbaroj! Pa diskutim që ky proces që kemi bërë tani do ta mbyll këtë histori. Unë i them çdo qytetari që ka probleme me Byronë apo çdo përfaqësues ligjor, nëse nuk e gjejnë emrin, t'i drejtohen Autoritetit dhe nuk kanë pse të lidhen me askënd, por vetëm të çojnë urdhrin e ekzekutimit.

Erion Braçe – Në Autoritet ku të drejtohen?

Ervin Koçi – Ata mund të dërgojnë një *email*, ne kemi marrë shumë kërkesa dhe i kemi zgjidhur.

Erion Braçe – Ku të vijnë?

Ervin Koçi – Të shkruajnë një *email*.

Erion Braçe – Po ju keni caktuar vetëm një njeri për këtë punë.

Ervin Koçi – Zoti kryetar, për këtë pikë është mbrojtja e konsumatorit që ka 4 persona.

Erion Braçe – Dakord, po jepni një adresë, se, përveç një reklame të një kompanie që u drejtohet të gjithë atyre që kanë dëme të pashlyera dhe i thërret në kompaninë e vet, unë nuk kam parë asnjë tjetër, asnjë prej kompanive të tjera nuk e bën këtë gjë dhe mbi të gjitha nuk e bën as Autoriteti këtë punë.

Ervin Koçi – Në muajin gusht ne kemi bërë një deklaratë për shtyp dhe e kemi shpërndarë, e kemi edhe në faqen tonë të internetit, për sensibilizimin e qytetarëve që të shkojnë të marrin paratë, nëse kanë ndonjë zvarritje menjëherë të kontaktojnë me *email* në adresën zyrtare të Autoritetit.

Erion Braçe – Është e gabuar kur thoni: “qytetarët të shkojnë të marrin paratë”. Cilët qytetarë, prandaj ju pyeta kujt i vjen radha më 12 shtator, kujt i vjen më 13 shtator e të tjera me radhë. Kjo është njësoj si radha e dekoderave para dy ditësh dhe, kur ti vete një, dy, tre herë, kthehesh në klient korrupsioni brenda këtyre kompanive.

Ervin Koçi – Kryetar, nëse shoqëria sot nuk reagon, qytetari me zyrë përmbarimore ia merr lekët menjëherë.

Erion Braçe – Me zyrë përmbarimore?

Ervin Koçi – Po, sepse i ka dalë autorizimi për pagesën.

Erion Braçe – Sa lekë paguan qytetari te zyra përmbarimore për të marrë paratë?

Ervin Koçi – Qytetari nuk paguan, këto i paguan shoqëria. Ky është edhe problemi që ka krijuar këtë ngërç, sepse në vitin 2012 është marrë një urdhër nga Ministria e Drejtësisë, e cila ndalonte zyrat përmbare të vepronin te shoqëritë për llogari të Byrosë për fondin e kompensimit. Ky ishte edhe shkaku përse dosjet akumuloheshin që nga viti 2012. Ne kemi bërë një takim me ministrin e Drejtësisë për këtë çështje dhe i kemi dërguar edhe një shkresë zyrtare, ku kërkonim që ky urdhër të zhvlerësohej, sepse më e rëndësishme është mbrojtja e konsumatorit. Tani autorizimi i jep 100% të drejtë qytetarit për të marrë menjëherë paratë pranë shoqërive të sigurimit.

Erion Braçe – Dakord, për të qenë i ndershëm me ju, unë do t'i kërkoj sot Kontrollit të Lartë të Shtetit të verifikojë të gjitha këto të dhëna.

Ervin Koçi – Dakord.

Erion Braçe – Pra, të gjithë marrëdhënien financiare të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me Byronë Shqiptare të Sigurimeve për sa i përket fondit të kompensimit. Pra, përveç kontrollit parlamentar, do të ketë edhe kontroll nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për këtë çështje.

A ka pyetje të tjera?

Fjalën e ka zoti Bushaj.

Xhavid Bushaj – Faleminderit!

Kisha edhe një pyetje në lidhje me urdhrin që paska lëshuar ministri i Drejtësisë zyrove të përmbaremit. Në dijeninë time është përcaktuar me ligj një çek listë dhe autoriteti që e ndjek këtë është Banka e Shqipërisë, që ua çon bankave të nivelit të dytë dhe pastaj operohet. Unë nuk e di se në çfarë kohe është nxjerr ky urdhër nga ministri i Drejtësisë.

Ervin Koçi – Ky është nxjerrë në vitin 2012 dhe u është dërguar zyrove përmbaremit, i cili ndalonte të drejtën për të hyrë në llogaritë e kompanive.

Xhavid Bushaj – Në vitin 2012, pra është ministri i qeverisë tjetër.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Fjalën e ka zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti drejtor!

Unë kam dy pyetje, e para, ndryshimet në rregulloren e raportimit dhe të mbikëqyrjes së Byrosë, a kanë dhënë rezultate në përmirësimin e punës tuaj?

E dyta, a ka neglizhencë dhe zvarritje në zbatimin e vendimeve të bordit të Autoritetit?

Faleminderit!

Ervin Koçi – Për çështjen e parë ka dhënë ndikim pozitiv, sepse nëpërmjet kësaj rregulloreje që ne miratuam kemi shpërndarë 95 milionë lekë nga dosjet të cilat ishin të pashpërndara.

Ndërsa për pyetjen e dytë, për sa i përket problematikës së zvarritjeve, padiskutim që ka pasur, por tashmë me ndryshimin e drejtorit të ri të Byrosë dhe me presionin ligjor të krijuar besoj se gjërat do të shkojnë në drejtim shumë pozitiv për të zbatuar çdo vendim të autoritetit.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Për të parë suksesin e gjithë masave që ju keni marrë, përfshirë edhe rregulloren, për të cilën pyeti zonja, gjithashtu për të parë edhe efektivitetin e shpërndarjes së dosjeve me produkt të drejtpërdrejtë pagimin e dëmeve për qytetarët, raportimi juaj do të jetë çdo dy javë. Që do të thotë, pranë këtij komisioni do të dërgoni informacion me shkrim çdo dy javë për shlyerjen e detyrimeve.

A ka ndonjë opinion tjetër? Nuk ka.

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA